LIGJ
Nr. 109/2012

PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË KONVENTËN PËR NJOHJEN E DIVORCEVE DHE NDARJEVE LIGJORE

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në Konventën për Njohjen e Divorceve dhe Ndarjeve Ligjore, bërë në Hagë më 1 qershor 1970.

Neni 2

Në kontekst të konventës, termi “divorc” ka të njëjtin kuptim me termin “zgjidhje e martesës”, të parashikuar në ligjin shqiptar.

Neni 3

Në përputhje me paragrafin e parë të nenit 19 të konventës, Republika e Shqipërisë rezervon të drejtën të refuzojë njohjen e një divorci ose të një ndarjeje ligjore ndërmjet dy bashkëshortëve, të cilët, në kohën e divorcit ose të ndarjes ligjore, kanë qenë shtetas të Republikës së Shqipërisë dhe të asnjë shteti tjetër, në rast se është aplikuar një ligj i ndryshëm nga ligji që referon legjislacioni shqiptar për të drejtën ndërkombëtare private, përveçse kur rezultati i arritur është i njëjtë me atë që është arritur duke zbatuar ligjin e referuar prej tij.

Neni 4

Në përputhje me nenin 21 të konventës, Republika e Shqipërisë rezervon të drejtën për të refuzuar njohjen e një ndarjeje ligjore kur, në kohën që ajo është marrë, njëri nga bashkëshortët ishte shtetas shqiptar ose i një shteti kontraktues, ligji i të cilit nuk e parashikonte ndarjen ligjore.

Neni 5

Në përputhje me paragrafin e dytë të nenit 24 të konventës, Republika e Shqipërisë deklaron se do të zbatojë dispozitat e Konventës për Njohjen e Divorceve dhe Ndarjeve Ligjore për divorcet dhe ndarjet ligjore të bëra para datës së hyrjes në fuqi të saj dhe rezervon të drejtën të mos e zbatojë atë kur aplikimi i dispozitave nuk sjell pasoja mbi të drejtat e pronësisë, të fituara nga çdo person përpara hyrjes në fuqi të konventës.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 15.11.2012

Shpallur me dekretin nr. 7843, datë 3.12.2012 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani